

**MARRËVESHJE PËR PUNËN NDËRMJET
ORGANIZATËS EVROPIANE TË PATENTAVE
DHE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËR BASHKËPUNIM PËR KËRKIMIN**

Organizata Evropiane e Patentave (në vijim referuar si “Organizata”), përfaqësuar nga Presidenti i Zyrës Evropiane të Patentave (në vijim referuar si “ZEP”),

PALA E PARË,

Dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (në vijim referuar si “DPPI”) nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

PALA TJETËR,

- Duke qenë se ZEP dhe DPPI do të emërtohen në vijim të kësaj marrëveshjë si “Palët”;
- Duke qenë se Republika e Shqipërisë ka shprehur dëshirën të paraqesë mundësinë për të hartuar raporte të zgjeruara për kërkimin që i besohen ZEP, brenda kuadrit të Rrjetit Evropian të Patentave;
- Duke qenë se Konventa Evropiane e Patentave dhe në veçanti nen 33, paragrafi 4 i saj, parashikon që Këshilli Administrativ i Organizatës mund të autorizoje Presidentin e ZEP të negociojë dhe të lidhë marrëveshje me shtetet;
- Duke qenë se, sipas Rregulloreve Shqiptare për lëshimin e patentave, një aplikim për patentë apo patentë, mund të iniciojë një raport për kërkimin paraprak mbi artit (në vijim referuar si “kërkim”);
- Duke qenë se ZEP është përcaktuar si autoriteti përgjegjës për kryerjen e këtyre kërkimeve;
- Duke qenë se procedura ndërkombëtare e TBP-së përfshin një raport ndërkombëtar kërkimi të shoqëruara me komente me shkrim dhe procedura evropiane përfshin një raport evropian të zgjeruar kërkimi;
- Duke qenë se dëshirohet t'i ofrohen aplikantit procedura të harmonizuara, duke i mundësuar të marrë që herët informacion për rezultatet e mundshme të testimt të shpikjes së tij për marrjen e patentës;

PALËT BIEN DAKORD SA MË POSHTË:

Neni 1
Përkufizimi i shërbimeve

ZEP merr përsipër të kryejë kërkimet për aplikimet kombëtare për patentë apo patentat, që i besohen nga DPPI dhe që janë të nevojshme për hartimin e raporteve të kërkimit. Këto raporte kërkimi të hartuara nga ZEP, shoqërohen me opinionin me shkrim nëse shpikja paraqitet si e re, që përfshin një hap shpikës dhe që është e zbatueshme në industri.

Neni 2
Dërgimi i kërkesave

- (1) Çdo kërkesë për kërkim që i dërgohet ZEP nga DPPI duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme:
 - numrin dhe datën e aplikimit për patentë dhe çdo klasifikim që i caktohet nga DPPI;
 - numrin e patentës dhe datën e dhënies së patentës, në rastin e patentave të dhëna;
 - datën, vendin e aplikimit dhe numrin e çdo aplikimi për patentë, për të cilën kërkohet prioritet;
 - numrin dhe datën e deklarimit të aplikimit të mëparshëm në rastet e aplikimeve të ndara;
 - titullin e aplikimit për patentë;
 - emrin e aplikantit dhe të çdo përfaqësuesi.
- (2) Çdo kërkesë për kërkim do të shoqërohet nga:
 - një kopje e plotë e aplikimit apo patentës për kërkim, e hartuar në një gjuhë zyrtare të ZEP, ose
 - një kopje e plotë e aplikimit e hartuar në gjuhën Shqipe dhe e shoqëruar nga përkthimi në gjuhën Angleze i pretendimeve, i përcaktuar sipas përgjegjësive të DPPI-së, dhe
 - një përkthim në gjuhën Angleze të përshkrimit, të hartuar nga mjete të pranuara nga ZEP;
 - me inicimin e DPPI-së ose të ZEP-së, derisa të hartohet raporti i kërkimit, këto përkthime mund të vendosen në përputhje me tekstin e aplikimit të paraqitur.

- (3) Nëse kërkohet nga ZEP, DPPI do të sigurojë një kopje të çdo kërkese për patentë, për të cilën kërkohet prioritet.

Neni 3

Mbajtja e të dhënave dhe dokumenteve

Dokumentet e përmendura në nenin 2 do të mbahen nga ZEP për një periudhë kohore të rënë dakord bashkërisht midis palëve.

Neni 4

Komunikimet dhe kondifencialiteti

- (1) Në kryerjen e punës që i është besuar, ZEP do të bashkëpunojë vetëm me DPPI-në, duke përashtuar të gjitha autoritetete tjera, aplikantët për patentë, dhe palët e treta. ZEP do të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të ruajtur konfidencialitetin e krijimeve.
- (2) Palët bashkërisht do të bien dakord për një mjet transmetimi i cili ruan sekretin, plotëson të gjitha kushtet e sigurisë dhe parandalon çdo dëmtim të artikujve të përcjellë.

Neni 5

Kërkimet dhe hartimet e raporteve të kërkimit

- (1) ZEP do të hartojë raporte të kërkimit në përputhje me Rregulloret Zbatuese të Konventës Evropiane të Patentës (KEP 2000) dhe veçanërisht Rregullin 61 (1), (2), (3), (4) dhe (6) të saj, dhe me Udhëzimin për Ekzaminimin në ZEP, veçanërisht Pjesën B të tij në lidhje me dispozitat e përmendura më sipër në Rregulloret Zbatuese.

ZEP do të hartojë opinione me shkrim sipas nenit 1 në përputhje me Rregulloret sipas PCT-së dhe veçanërisht Rregullit 43 të saj, dhe Pjesës V të Udhëzuesit Ndërkombëtar të Kërkimit të PCT-së në lidhje me dispozitat e përmendura më sipër në Rregulloren në fjalë.

Marrëveshjet e veçanta për zbatimin e Udhëzimeve në fjalë gjatë hartimit të raporteve të kërkimit dhe opinioneve me shkrim do të miratohen bashkërisht midis palëve.

- (2) Nëse ZEP konsideron se aplikimi nuk plotëson kërkësën e unitetit të shpikjes, ajo do të hartojë raportin e kërkimit për ato pjesë të aplikimit që kanë të bëjnë me shpikjen ose grupin e shpikjeve të përmendura fillimisht tek kërkësat. Kjo do të paraqitet në raportin e kërkimit dhe opinionin me shkrim.
- (3) ZEP nuk është e detyruar të kryejë një kërkim për një aplikim për patentë e cila

lidhet me, dhe deri në masën e nevojshme që lidhet me, çdo çështje që nuk është e patentuar sipas nenit 5, paragrafi 2 dhe nenit 6 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar.

- (4) Nëse ZEP konsideron se aplikimi përmban mangësi që pengojnë kryerjen e një kërkimi të logjikshëm në lidhje me disa ose të gjitha pretendimet,
- (a) sepse ka lidhje me subjektin, për të cilën sipas paragrafit 3, ZEP nuk është e detyruar që të kryejë kërkime,
- (b) ose sepse përshkrimi, pretendimet apo skicat përbajnjë paqartësi, mospërputhje ose kundërshtime,

ZEP do të deklarojë, sipas kushteve të arsyeshme, që një kërkim i logjikshëm është i pamundur ose do të hartojë, sa më shpejt, një raport të pjesshëm të kërkimit. Deklarata e ZEP-së ose rapporti i pjesshëm do të konsiderohet si raport kërkimi brenda kuptimit të kësaj marrëveshjeje dhe shoqërohet me një opinion me shkrim.

Neni 6

Gjuha, prezantimi dhe dërgimi i reportit të kërkimit

- (1) Raporti i kërkimit dhe opinioni me shkrim duhet të hartohen në gjuhën angleze dhe të paraqiten në një formular standard që do të miratohet nga palët.
- (2) ZEP do t'i përcjellë DPPI-së reportin e kërkimit, dokumentet e cituara dhe opinionin me shkrim në disa kopje, dhe ky numër i kopjeve duhet të përcaktohen me marrëveshje të përbashkët midis palëve.
- (3) ZEP do t'i vendosë në dispozicion këto informacione pa pagesë sipas nevojës së DPPI-së në çdo pikë të çdo reporti kërkimi, apo opinioni me shkrim të hartuar nga ZEP.

Neni 7

Aplikimet e ndara

Çdo report kërkimi i lidhur me një aplikim të ndarë do të trajtohet si një report kërkimi më vete. Raportet e kërkimit që lidhen me një aplikim të ndarë do të shoqërohen nga një opinion me shkrim.

Neni 8
Kërkim shtesë

ZEP, me kërkjesë të DPPI-së, do të kryejë çdo kërkim shtesë i cili konsiderohet se është i nevojshëm gjatë procedurave të DPPI-së. Çdo raport i kërkimit shtesë do të trajtohet si një raport kërkimi i veçantë. Raportet e kërkimit shtesë do të shoqërohen nga një opinion me shkrim.

Neni 9
Limitet kohore

- (1) Nëse aplikimi për patentë është aplikim për herë të parë (p.sh. nuk kërkon prioritet), ZEP harton reportin e kërkimit, të shoqëruar nga opinioni me shkrim, brenda nëntë muajve nga data e dorëzimit të aplikimit, me kusht që kërkesa e kërkimit të jetë pranuar jo më vonë se pesë muaj pas datës së dorëzimit. Nëse kërkesa për kërkim është pranuar më vonë se pesë muaj pas datës në fjalë, ZEP duhet të përpinqet të hartojë reportin e kërkimit para se të përfundojë periudha e prioritetit.
- (2) Nëse aplikimi për patentë nuk është aplikim për herë të parë (p.sh. kërkon përparësi nga të paktën një aplikim i mëparshëm), ZEP do të hartojë reportin e kërkimit, të shoqëruar nga opinioni me shkrim, sa më shpejt të jetë e mundur, duke pasur parasysh afatet kohore që janë aplikuar në përgjithësi gjatë hartimit të raportit të kërkimit në aplikimet për patentë kombëtare të cilat nuk janë aplikime për herë të parë dhe që i janë besuar ZEP sipas marrëveshjeve të punës.
- (3) Nëse ZEP, merr një kërkjesë për të kryer një kërkim në lidhje me një patentë kombëtare, do të hartojë reportin e kërkimit të shoqëruar me një opinion me shkrim, brenda nëntë muajve pas marries së kërkjesës.
- (4) Afati i përcaktuar në paragrafin 1 ose 3 mund të ndryshohet me marrëveshje të përbashkët midis palëve.

Neni 10
Dokumentacioni

ZEP do të kryejë kërkimet sipas kësaj marrëveshje duke përdorur dokumentacionin e përdorur për hartimin e raporteve evropiane dhe ndërkombëtare të kërkimit.

Neni 11
Dispozita Financiare

(1) Të gjitha shumat që duhet të paguhen sipas kësaj marrëveshjeje, do të paguhen në euro nga DPPI në llogarinë e specifikuar nga ZEP.

(2) Për çdo raport kërkimi të hartuar nga ZEP, DPPI do t'i paguajë ZEP-it një tarifë.

Shuma e kësaj tarife do të jetë e barabartë me çmimin e plotë të kostos të një rapporti kërkimi të tillë, të shoqëruar me opinion me shkrim, minus një zbritje duke marrë parasysh faktorët objektivë të përcaktuar në të njëjtën mënyrë si në marrëveshjet e punës me pesë shtetet e mëparshme të IIB-së. Këta faktorë objektivë lidhen veçanërisht me numrin e aplikimeve evropiane dhe ndërkombëtare që kërkojnë prioriteten e një aplikimi kombëtar për të cilat një raport kërkimi është hartuar më parë nga ZEP, kostot administrative të këtyre deklarimeve, kursimin e kohës për një analizues gjatë zhvillimit të procedurave evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe rregullimet për alokimin dhe klasifikimin e dosjeve.

Vlera e tarifës e aplikueshme për një raport kërkimi të shoqëruar nga opinioni me shkrim përcaktohet nga Këshilli Administrativ i Organizatës për një periudhë tre vjeçare dhe kjo tarifë do të jetë e njëjtë për Qipron, Greqinë, Italinë, Letoninë, Lituani, Maltën, Monakon, San Marinon dhe Mbretërisë së Bashkuar.

Një vit përpara përfundimit të kësaj periudhe tre vjeçare, ZEP do të rishikojë vlerën e tarifës së parashikuar në paragrin 3, duke marrë parasysh çdo ndryshim në parametrat objektivë, duke përfshirë veçanërisht vlerën e tarifave të kërkimit të përcaktuara nga ZEP për procedurat evropiane dhe ndërkombëtare.

(3) Tarifa e parashikuar në paragrin 2 do të rritet, për çdo raport kërkimi, me një vlerë të sheshtë, të përcaktuar nga ZEP, për të mbuluar çmimin e kostos të kopjeve të dokumenteve të përmendura në nenin 6, parografi 2.

Neni 12
Limiti kohor për pagesë

ZEP do t'i dërgojë DPPI-së deklarata mujore të shumave që i detyrohet. DPPI-ja do të paguajë këto detyrime brenda tridhjetë ditëve nga marrja e tyre.

Neni 13
Monitorimi i punës së kërkimit

Palët së bashku do të ushtrojnë kontolle sasiore dhe cilësore të punës së kryer, sipas kësaj marrëveshjeje dhe do të studiojnë mënyrat për ta përmirësuar atë.

Neni 14

Trajnimi i stafit teknik

Nëse kërkohet nga DPPI, dhe sipas kushteve të pranuara bashkërisht midis palëve, ZEP do të ndihmojë në trajnimin e stafit teknik të DPPI-së dhe do të dërgojë në mënyrë të përkohshme personelin e ZEP-it në DPPI për të kryer çdo punë që lidhet me këtë marrëveshje.

Neni 15 Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje midis DPPI-së dhe Organizatës në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshje dhe që nuk zgjidhet me negocim, do të dërgohet në një gjykatë arbitrazhi prej tre anëtarësh, vendimi i të cilit do të jetë i formës së prerë. Një arbitër do të emërohet nga DPPI-ja, një nga Organizata dhe një nga një i tretë, i cili do të veprojë në cilësinë e kryetarit, nga dy të tjera. Nëse, 3 muaj pas emërimit të tyre, dy arbitrat e parë nuk bien dakord për emërimin e të tretit, ky i fundit do të emërohet, me kërkesë të DPPI-së ose Organizatës, nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë ligjin e zbatueshëm që do të aplikohet për mosmarrëveshjen.

Neni 16 Rishikimi

Me miratimin e Këshillit Administrativ, kjo marrëveshje mund të rishikohet, në veçanti përmes shkëmbimit të letrave, me kërkesë të secilës palë kontraktuese.

Neni 17 Dispozita përfundimtare

Data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje do të përcaktohet bashkarisht nga palët, në vijim të realizimit në praktikë të aspekteve teknike të cilat janë të nevojshme përfundimtare funksionimin e kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja do të zbatohet në aplikimet përfundimtare të patentave të depozituara ne DPPI nga data e hyrjes në fuqi dhe në patentat kombëtare të dhëna që nga data 1 Maj 2010.

Neni 18 Dispozita kalimtare

Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, vlera e tarifës së përmendur në nenin 11 paragrafi 2, do të jetë e barabartë me shumën që duhet të paguhet po në atë datë nga grupe i shteteve që përfshijnë Qipron, Greqinë, Italinë, Letoninë, Lituaniq, Maltën, Monakon, San Marinon dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Geschehen in zwei Ausfertigungen in deutscher, englischer, französischer und albanischer Sprache, wobei jeder Wortlaut gleichermaßen verbindlich ist.

Done in two copies in English, French, German and Albanian, the four texts being equally authentic

Fait en double exemplaire en langues albanaise, allemande, anglaise et française, les quatre textes faisant également foi.

Hartuar në dy kopje, në gjuhët anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe shqip, të katër tekstet njëloj autentike.

Munich,11.09.....2020

Tirana,.....2020

Für die Europäische Patentorganisation

For the European Patent Organisation

Pour l'Organisation européenne des brevets

Në emër të Organizatës Evropiane të Patentave

Für die Generaldirektion für gewerblichen Rechtsschutz der Republik Albanien

For the General Directorate of Industrial Property of the Republic of Albania

Pour la Direction générale de la propriété industrielle de la République d'Albanie

Në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale

António Campinos

Präsident des Europäischen Patentamts
President of the European Patent Office
Président de l'Office européen des brevets
President i Zyrës Evropiane të Patentave

Ledina Beqiraj

Generaldirektorin
Director General
Directrice générale
Drektor i Përgjithshëm

